

Mergime Tefiki, MA¹

UDC: 159.955.6:373.5.091.3(497.751)

**RAPORTI MES STILEVE TË TË MËSUARIT, TË
MENDUARIT KRITIK DHE STILET E MËSIMDHËNIES NË
SHKOLLAT E MESME TË QYTETIT TË TETOVËS**

**ОДНОС МЕЃУ СТИЛОВИТЕ НА УЧЕЊЕ, КРИТИЧКОТО
РАЗМИСЛУВАЊЕ И СТИЛОТ НА НАСТАВАТА ВО
СРЕДНИТЕ УЧИЛИШТА НА ГРАД ТЕТОВО**

**RELATIONSHIP BETWEEN LEARNING STYLES, CRITICAL
THINKING AND TEACHING STYLES IN SECONDARY
SCHOOLS OF THE CITY OF TETOVO**

Abstract

The purpose the thesis: “Relationship between learning styles, critical thinking and teaching styles in secondary school in Tetovo” is to investigate the relationship between learning styles, critical thinking skills and teaching styles in high school in the city of Tetovo, to argue that in the relationship of student-teacher attitude, critical thinking skills, and styles of teaching by teachers, to verify which style of learning is more present in students, which style has the highest correlation with ability of critical thinking and what is the style that is applied by teachers during the teaching process .

The research is conducted in six high schools in the city of Tetovo SH.M.K Gjimnazi “7 Marsi”, “Kiril Pejinovic”, SH.M.K.M. “ Nikola Shtejn “, SH.M. “8 Shtatori”, SH.M.P.K “Moshja Pijade”, “Gjoce Stojcevski”, “Isa Beu” with 211 students. Instrument that is used: learning style questionnaire- University of California, with 12 items ($\alpha = 0.320$)

¹ Mr.Sc. Mergime Tefiki, Vision Academy, mergimetefiki@gmail.com

and Stella Cotrre questionnaire on ability of critical thinking skills with all 25 questions ($\alpha = 0.867$). A total of 56 teachers have completed the questionnaire: Staffordshire Teaching Styles Assessment (SETS). Reproduced with the permission of Kay Mohanna, Ruth Chambers, David Wall, with 24 questions showing six teaching styles ($\alpha = 0.720$).

The results confirm that there are no significant differences in learning styles. There are gender differences in favor of female gender in critical thinking skills. Teaching style: the only teacher, who did not pay attention to the student's progress had a higher average than other teaching styles. The results confirmed differences between success and critical thinking skills.

Key words: learning styles, critical thinking skills, teaching styles, students

Hyrje

Klasat përbëhen nga disa nxënës, që janë veçohen nga njëri-tjetri. Secili prej tyre ka personalitetin e vet, karakterin, ka idetë e veta, ka formën e vet e të menduarit, mënyrën e vet të të nxënës. Po ashtu ka edhe stilin e vet e të mësuarit. Dikush mëson më shpejt duke dëgjuar, dikush duke i parë me sy lëndët dhe në ato që zhvillohen (tipi vizual) dikush duke u përfshirë në aktivitete (tip pragmatist). Këto janë ato tipa që janë më shumë të njohur, por çfarë nënkuptojnë në fakt këto tipa, sa të rëndësishme janë.

Studime të shumta janë kryer mbi mospërputhjen dhe përputhjen e stileve të të nxënës dhe stileve të mësimdhënies (p.sh. Naimie et al 2010; Massa dhe Mayer 2006; Tuan 2011). Shumica e tyre i referohen përputhjes së të dyve si një ndikim pozitiv në performancën e nxënësve dhe tregojnë të kundërtën për mospërputhjen. Sidoqoftë, mospërputhjet ndonjëherë mund të jenë të dobishme sidomos me nxënësit e nivelit të ulët (Peacock 2001) si dhe aftësimi i të menduarit kritik të nxënësit. Qëllimi i këtij studimi është të paraqesë disa argumente për këtë çështje.

Për të pasur qëndrime pozitive në raportin nxënës-mësimdhënës, nxënës-nxënës duhet të krijohet një lidhje emocionale bashkëpunuese për rezultate të suksesshme. Nëse krijohet kjo lidhje e ngushtë në mes nxënësve dhe mësimdhënësit do të mësojnë që të respektohet idetë e secilit nxënës. Mësimdhënësit duhet të organizojnë forma të ndryshme me qëllim që të mbajnë atmosferën e të nxënës dhe të bashkëpunimit ndërmjet njëri tjetrit (Musai, 2003).

I. Korniza teorike e hulumtimit

1.1 Përkufizimi i stileve të të nxënit

Në letërsi janë përdorur terma të ndryshëm si stili i të mësuarit, stili njohës, preferenca shqisore dhe llojet e personalitetit. Disa nga këto terma, në disa raste, janë përdorur në vend të njëjtë, ndërsa në raste të tjera ato janë diferencuar (Cassidy, 2004). Stili i të mësuarit përcaktohet si “mënyra komplekse dhe kushtet në të cilat nxënësit në mënyrë më efektive perceptojnë procesin, ruajnë dhe kujtojnë atë që po përpiqen të mësojnë” (James dhe Gardner, 1995: 20), ndërsa stilet kognitive përcaktohen si “Mënyra (të) natyrore, e zakonshme dhe e preferuar e individëve për thithjen, përpunimin dhe mbajtjen e informacionit dhe aftësive të reja” (Reid, 1995).

1.2 Përkufizimi i të menduarit kritik

Kur kërkohet termi “Mendimi kritik”, kuptohet që ka kuptime të tij korniza e shkencave të filozofisë dhe psikologjisë, por në kuptimin e përgjithshëm, ky term nuk ka marrë një kuptim të caktuar. ‘Kritik’, që rrjedh nga fjala greke kritikos që do të thotë të gjykosh, doli nga mënyra se si analiza dhe argumenti sokratik menduan në atë kohë (McGregor, 2007) dhe pastaj fjala kritikos i kaloi Latinas ‘Criticus’ që është lloji i përhapjes në gjuhët e botës prej tij (Hançerlioglu, 1996).

Sipas Innis (2015), të menduarit kritik përfshin disa hapa, shumica e të cilëve të rriturit veprojnë pa u menduar shumë. Këto hapa përfshijnë identifikimin e çështjes, mendimin për qëllimin, idetë për zgjidhjet e mundshme. Mendoni përmes rezultateve të mundshme, provoni një nga zgjidhjet, dhe së fundi, vlerësoni rezultatin. Sidoqoftë, Hayes dhe Devitt (2008) tregoi se tek nxënësit e klasave të ulëta, strategjitë e të menduarit kritik nuk janë zhvilluar ose praktikuar gjerësisht gjatë arsimit fillor dhe të mesëm. Prandaj, mësuesit janë të detyruar të ndihmojnë studentët të zhvillojnë aftësitë e nevojshme për të sintetizuar nuancat e një shoqërie moderne, komplekse.

1.3 Stilet e të mësuarit në mësimdhënie

Për shumë vite, metoda e ligjërimit të drejtpërdrejtë ishte metoda kryesore mësimore e përdorur nga shumica e mësuesve (Santrock, 2006). Ishte më shumë e përqendruar tek instruktori me qëllimin e transferimit të njohurive, aftësive dhe informacionit nga instruktori tek nxënësit. Në këtë kontekst, instruktori kontrollon përmbajtjen dhe ritmin e kursit. Sidoqoftë, hulumtimi arsimor ka demonstruar se nxënësit mësojnë më mirë kur janë në gjendje të mësojnë përmes zbulimit, duke vendosur ritmin e të mësuarit të tyre me trajnimin e instruktorit, duke

mentoruar ose lehtësuar njohuritë e tyre, aftësitë dhe marrjen e informacionit. Kjo metodologji e mësimdhënies përshkruhet si e përqendruar te nxënësi (Santrock, 2006).

Idetë e John Dewey formuan kuptimin tonë për fëmijët si nxënës aktivë dhe mbrojtë qe mësuesit të angazhojnë nxënësit në procesin e të mësuarit (Glassman, 2001). Edward Thorndike sugjeroi që detyra më e rëndësishme e arsimit është të theksojë aftësitë arsyetuese të nxënësve (Beatty, 1998).

II. Korniza metodologjike

2.1 Problemi i hulumtimit

Nga literatura dhe njohuritë paraprake formulojmë problemin e hulumtimit që ngërthen në vete variablat kryesore të studimit: stilet e të mësuarit te nxënësit, të menduarit kritik dhe stilet e mësimdhënësve te nxënësit e shkollave të mesme.

A ka lidhshmëri mes stileve të të mësuarit dhe zhvillimit të të menduarit kritik te nxënësit e shkollave të mesme?

Problemin e hulumtimit në çdo element mund ta ndajmë në pyetje kërkimore:

1. Cili është stili dominues i të mësuarit te nxënësit?
2. Cili është stili dominues i mësimdhënies nga ana e mësimdhënësit?
3. Si qëndron raporti i stilit të të mësuarit dhe të menduarit kritik?

2.2 Qëllimet e hulumtimit

Qëllimi i hulumtimit është të përshkruajë prezencën e variablave përkatëse qëllimi është të mësojmë se cili është stili më dominues i të mësuarit te nxënësit, cili është raporti mes stileve të të mësuarit te nxënësit dhe cili është përdorimi i stilit te mësimdhënësit.

2.3 Detyrat e hulumtimit

Në bazë të problemit që kemi përcaktuar kemi formuluar detyrat përkatëse që ky studim me qasje kuantitative tenton të arrijë:

- Të hedhë dritë mbi konceptet e stileve të të mësuarit.
- Të zbulohet se cili stil i të mësuarit është më prezent.
- Të vlerësohet zhvillimi i aftësisë së të menduarit kritik te nxënësit.
- Të shohim sa mësuesit përdorin stile të mësimdhënies.

2.4 Hipotezat e hulumtimit

Nga të dhënat do të shohim vërtetimin apo refuzimin e hipotezave që janë paraqitur në bazë të hulumtimit me disa hipoteza dhe disa nënhipoteza:

H. Ekziston shpërndarje normale e variablave për stilet e të mësuarit, aftësitë e të menduarit kritik.

H1.1 Ekziston shpërndarje normale e variablës stilet e të mësuarit.

H1.2 Ekziston shpërndarje normale e variablës aftësitë e të menduarit kritik.

H1.3 Ekziston shpërndarje normale e stileve të mësimdhënies.

H2. Supozojmë se ka stile të ndryshme të të mësuarit. Stili vizual është më dominues te nxënësit.

H3. Supozojmë se nxënësit kanë aftësi për të menduarit kritik mbi mesataren e pritur.

H4. Ka dallime mes suksesit dhe aftësisë së të menduarit kritik. Me rritjen e suksesit rritet edhe aftësitë e të menduarit kritik.

2.5 Definimi i variablave

Stilet e të mësuarit

Përcaktimi teorik: Stilet e të mësuarit. Nocioni i stilit i referohet mënyrës së preferuar të personit për të përdorur aftësitë e tij/saj (dhe në këtë mënyrë ndryshon nga aftësia), dhe është një faktor shumë i rëndësishëm në përpjekjen për të llogaritur ndryshimet individuale të theksuara në performancën e treguar nga njerëzit derisa mendojnë, mësoni ose kryeni detyra të ndryshme.

Përcaktimi operacional: Stilet e të mësuarit te nxënësit është përpiluar nga Qendra e këshillimit dhe mësimit të studentëve Merced pranë Universitetit të Kalifornisë, me 24 ajteme.

Aftësitë e të menduarit kritik

Përcaktimi teorik: Kur kërkohet termi ‘Mendim kritik’, kuptohet që ka kuptime të tij që sugjerohen në kornizën e shkencave të filozofisë dhe psikologjisë, por në kuptimin e përgjithshëm, ky term nuk ka marrë një kuptim të caktuar. ‘Kritik’, që rrjedh nga fjala greke kritikos që do të thotë të gjykosh, doli nga mënyra se si analiza dhe argumenti sokratik menduan në atë kohë. (McGregor, 2007).

Përcaktimi operacional: Aftësimi i të menduarit kritik është matur me një pyetësor prej 25 pohimeve të vetë-vlerësimit për veten e tyre nga ana e nxënësve.

Stilet e mësimdhënies


Përcaktimi teorik: Stilet e mësimdhënies. Stilet e mësimdhënies i referohen “mënyrës së preferuar të një mësuesi për të zgjidhur problemet, kryerjen e detyrave dhe marrjen e vendimeve në procesin e mësimdhënies dhe përveç që ndryshon nga individi në individ, ndonjëherë mund të ndryshojë midis grupeve të ndryshme, për shembull shkolla” (Sternberg, 1997).

Përcaktimi operacional: Stilet e mësimdhënies do të maten përmes pyetësorit (SETS). Riprodhuar me lejen e Kej Mohanna, Ruth Chambers, David Wall, Staffordshire University 2007, me 24 pyetje apo ajteme (items).

2.6 Popullata dhe mostra

Mostra e hulumtimit përfshin nxënësit e shkollave të mesme të qytetit të Tetovës. Kampionin e përbëjnë 211 nxënës të shkollave të mesme. *Ku kemi shkollat SHMK Gjinnazi "7 Marsi", gjinnazi "Kiril Pejçinoviç", SHMKM "Nikolla Shtejn", SHM Ekonomike "8 Shtatori", SHMPK "Mosha Pijade", shkolla tekstile "Gjoce Stojçevski", dhe medreseja "Isa Beu" dhe 56 mësimdhënës të po këtyre shkollave.*

Shkollat që kanë marrë pjesë në studim



Grafikoni 1. Paraqitja grafike e shkollave pjesëmarrëse në studim te mësimdhënësit

Tabela 1. Të dhënat për numrin e subjektëve (nxënës) të përfshirë në studim

Shkollat				
	Frekuenca	Përqindja %	Përqindja valide	Përqindja kumulative
SHMK Gjinnazi "7 Marsi"	59	28.0	28.0	28.0
Gjinnazi "Kiril Pejçinoviç"	47	22.3	22.3	50.2
SHMKM "Nikolla Shtejn"	85	40.3	40.3	90.5
SHM Ekonomike "8 Shtatori"	7	3.3	3.3	93.8
SHMPK "Mosha Pijade"	4	1.9	1.9	95.7
Shkolla tekstile "Gjoce Stojçevski"	2	.9	.9	96.7
Medreseja "Isa Beu"	7	3.3	3.3	100.0
Gjithsej	211	100.0	100.0	

Nxënësit kanë plotësuar pyetësonin me pjesëmarrje vullnetare domethënë nuk është bërë përzgjedhje e rastësishme e subjekteve. Në hulumtim kanë marrë pjesë 59 nxënës (28%) nga shkolla gjimnazi SHMK “7 Marsi”, 47 nxënës (22%) gjimnazi “Kiril Pejçinoviç”, 85 nxënës (40%) SHMKM “Nikolla Shtejn”, 7 nxënës (3%) shkolla Ekonomike “8 Shtatori”, 4 nxënës (2%) “Mosha Pijade”, 2 nxënës (1%) shkolla e mesme e tekstit “Gjoce Stojçevski”, dhe 7 nxënës (3%) medreseja “Isa Beu”. Gjithsej në hulumtim kanë marrë pjesë 211 nxënës nga shkollat e mesme të lartpërmendura.

III. Rezultatet e hulumtimit

3.1 Rezultate nga analiza deskriptive

Tabela 2. Të dhënat deskriptive për stilet e të mësuarit

Stilet e të mësuarit				
		Vizuel	Auditor	Kinestetik
Mesatarja		14.77	13.51	13.23
Mediana		14.00	14.00	14.00
Devijimi Standard		2.966	3.228	2.881
Skewness		-.328	.029	.108
Std. Gabimi i Skewness		.167	.167	.167
Minimum		6	6	4
Maksimum		20	20	20

Nga të dhënat deskriptive për stilet e të mësuarit kemi këto rezultate për të tre stilet, te stili vizual mesatarja është $M = 14.77$, ndërsa mediana $Mdn = 14.00$, devijimi standard është $DS = 2.966$. Te të dhënat për stilin e të mësuarit auditor te nxënësit kemi këto rezultate: mesataren $M = 13.51$, mediana $Mdn = 14.00$, devijimi standard $DS = 3.228$. Dhe stili kinestetik apo taktil (prekjes) kemi këto rezultate mesataren $M = 13.23$, mediana është $Mdn = 14.00$, devijimi standard është $DS = 2.881$. Nga interpretimi i rezultateve shohim që kemi vlera pothuajse të përafërta me njëra tjetrën te mesatarja ndërmjet stileve të të mësuarit dhe të nxënit nga nxënësit, po ashtu edhe medianën e kemi të barabartë te tre stilet e të mësuarit, te devijimi standard, skewness dhe gabimi i skewnessit edhe këtu kemi vlera të afërta.


Nga këto rezultate mund të konstatojmë se në tre stilet e të mësuarit përkatësisht stili vizual, auditor dhe kinestetik nuk kemi dallime të konsiderueshme të larta në vlerat mesatare të tyre.

Tabela 3. Të dhënat deskriptive në lidhje me aftësitë e të menduarit kritik

Të menduarit kritik	
Mesatarja	75.03
Mediana	76.00
Devijimi Standard	11.209
Skewness	-.506
Std. Gabimi i Skewness	.167
Minimum	29
Maksimumi	100

Nga të dhënat deskriptive për aftësitë e të menduarit kritik nga rezultatet më sipër kuptojmë që mesatarja është $M = 75.03$, devijimi standard $DS = 11.209$, Skewness është -0.506 , Gabimi i Skewness është -0.167 , minimumi $Min = 29$, ndërsa maksimumi $Max = 100$.²

Mesatarja e përfituar te nxënësit $M = 75.03$ është më e lartë se mesatarja e pritur $M = 50$ nga kjo konstatojmë se nxënësit kanë aftësi për të menduarit kritik të lartë.



Grafikoni 2. Paraqitja grafike për stilet e mësimeve

² Vlera maksimale e pyetësorit është 100 kur pjesëtohet me dy është 50 kështu që mesatarja e pritur është 50.

Tabela 4. Të dhënat deskriptive për stilet e mësimdhënies

		Stili 1	Stili 2	Stili 3	Stili 4	Stili 5	Stili 6
Mesatarja		6.98	8.55	7.89	9.02	7.25	11.50
Mediana		7.00	9.00	8.00	9.00	7.00	12.00
Std. Devijimi Standard		1.700	2.223	1.923	2.385	1.740	2.248
Skewness		.374	-.027	-.033	.503	.287	.149
Std. Gabimi i Skewness		.319	.319	.319	.319	.319	.319
Minimum		4	4	4	5	4	6
Maksimum		11	13	12	15	11	18
Përqindja	25	6.00	7.00	7.00	7.00	6.00	10.00
	50	7.00	9.00	8.00	9.00	7.00	12.00
	75	8.00	10.00	9.00	10.00	8.00	13.00

Të dhënat për stilin mësuesi fleksibël dhe i adaptueshëm të mësimdhënësve tregojnë që mesatarja është e barabartë $M = 6.98$, ndërsa mediana është $M_{nd} = 7.00$, devijimi standard është $DS = 1.700$. Te stili mësuesi, nxënësi në qendër, i ndjeshëm kemi një mesatare $M = 8.55$, mediana është $M_{nd} = 9.00$, ndërsa devijimi standard $DS = 2.223$. Të dhënat e stilit mësuesi ndjekës i kurrikulës kemi mesatare $M = 7.89$, medianë $M_{nd} = 8.00$, devijimi standard $DS = 1.923$. Stili faktet e drejta me biseda të qarta i mësimdhënies tregojnë këto rezultate: mesataren $M = 9.02$, mediana $M_{nd} = 9.00$, devijimi standard $DS = 2.385$. Te stili mësuesi ligjërues para një auditori më të madh kemi një mesatare $M = 7.25$, mediana $M_{nd} = 7.00$, devijimi standard është $DS = 1.740$. Stili mësuesi i vetëm, që nuk ndjek progresin e nxënësve mesatarja është $M = 11.50$, mediana $M_{nd} = 12.00$. Nga të dhënat e paraqitura më lart të rezultateve të përgjithshme vërejmë që mesatarja më e lartë është te stili i gjashtë i cili është: mësuesi që nuk ndjek progresin e nxënësve, këtyre mësimdhënësve ju pëlqen të sqarojnë me përmbajtje të shkurta mbi një bazë, ku më pas vjen stili i katër me mesatare më të lartë që është: mësuesi me fakte të drejta dhe me biseda të qarta, duke u përqendruar në aftësi specifike dhe preferon të mos përfshihen me mësimdhënies multidisiplinore të të mësuarit. Përafërsisht te të gjithë stilet e mësimdhënies kemi një mesatare të barabartë, poashtu edhe medianën e kemi më të lartë te stili i gjashtë i mësimdhënies kurse stilet tjera kanë medianë përafërsisht të barabartë, po ashtu edhe te devijimi standart, te Skewness dhe te gabimi i Skewnessit te stili i gjashtë i mësimdhënies kemi

vlera më të larta, ndërsa te stilet tjera kemi vlera përafërsisht të njëjta apo të barabarta.

3.2 Rezultate nga analiza korrelative

Tabela 5. Të dhënat korrelative për stilet e të mësuarit dhe aftësisë së të menduarit kritik

		Vizuel	Auditor	Kinestetik
Aftësitë e të menduarit kritik	r	0.290**	.318**	.211**
	Sig. (2-tailed)	.000	.000	.002
	N	211	211	211

** . Korelacioni është signifkant në nivelin 0.01 (2-kahësh).

Sipas tabelës 18 mes aftësisë për të menduarit kritik dhe stilit vizual ka korrelacion të dobët $r = 0,29$; $p < 0.01$ statistikisht i rëndësishëm, mes aftësisë për të menduar kritik dhe stilit të të mësuarit auditor ka gjithashtu korrelacion të dobët dhe të rëndësishëm statistikor, dhe mes aftësisë së të menduarit kritik dhe stilit të të mësuarit kinestetik ka korelacion gjithashtu të dobët dhe të rëndësishëm statistikisht.

Nga kjo konstatojmë se ekziston një korrelacion i dobët mes aftësisë së të menduarit kritik dhe stileve të të mësuarit.

Tabela 6. Analizat e testit të Levenit dhe t - testit për aftësitë e të menduarit kritik

	F	Sig.	t	df	Sig. (2-kahësh)	Diferenca Mesatare
Aftësitë e të menduarit kritik	.745	.389	2.772	209	.006	4.987
			2.515	69.376	.014	4.987

Në këtë tabelë shohim që të dhënat për aftësitë e të menduarit kritik grupet kanë homogjenitet, këtë e konstatojmë nga signifikanca e cila është më e madhe 0.05.

Nga rezultatet e tabelës shohim që ka dallime gjinore në mes grupeve mbi aftësitë e të menduarit kritik Levenes test është 0.389, ndërsa t - testi është $t(209) = 2.772$; $p < 0.05$ domethënë që ka dallime në mes grupeve.

Tabela 7. Analizat e testit të Levenit dhe t - testit

	F	Levene's test.	t - test	df	Sig.	Diferenca Mesatare
Vizuel	5.586	.019	2.540	209	.012	1.213
			2.248	67.361	.028	1.213
Auditor	.034	.854	-.310	209	.757	-.164
			-.300	75.656	.765	-.164
Kinestetik	11.175	.001	-.543	209	.587	-.256
			-.458	63.918	.648	-.256

Sipas analizës së testit të Levenit grupet në lidhje me dallimet gjinore për stilin vizual dhe kinestetik nuk kanë homogjenitet në variancë.

Nga analiza e testit të Levenit grupet për dallimet gjinore në stilin auditor janë homogjene signifikanca është sig = 0.85, në analizat e dallimeve t - testit kemi përfituar këto vlera t - testi është t = -0.310 , df = 209, ³ sig = 0.75 në mes grupeve nuk ka dallime signifikante (testit të Levenit dhe t - testit).

Tabela 8. Të dhënat deskriptive për aftësitë e të menduarit kritik në lidhje me suksesin

Aftësitë e të menduarit kritik					
	N	Mesatarja	Std. Devijimi Standard	Minimum	Maksimum
Mjaftueshëm (2)	12	65.58	14.100	29	80
Mirë (3)	34	73.53	10.013	52	89
Shumë mirë (4)	66	74.59	10.745	50	98
Shkëlqyeshëm (5)	99	76.99	10.993	45	100
Shuma	211	75.03	11.209	29	100

Nga rezultatet deskriptive të aftësitë e të menduarit kritik në lidhje me suksesin e arritur të nxënësve nga tabela shohim që me rritjen e suksesit të nxënësve kemi edhe rritje të aftësive të të menduarit kritik. Mesatarja e nxënësve që kanë sukses të mjaftueshëm është M = 65.58, devijimi standard DS = 14.100, të nxënësve që kanë sukses të mirë kemi

³ Degrees of freedom (df) shkallët e lirisë.

mesataren $M = 73.53$, devijimin standard $DS = 10.013$, kurse te nxënësit që kanë sukses shumë të mirë kemi mesataren $M = 74.59$, devijimi standard $DS = 10.745$, dhe te nxënësit që kanë sukses të shkëlqyeshëm mesatarja është $M = 76.99$, ndërsa devijimi standard $DS = 10.993$. Nga këto rezultate kuptojmë që me rritjen e suksesit të nxënësve kemi edhe rritje të aftësive të të menduarit kritik, për shkak se te nxënësit që kanë sukses të mjaftueshëm kemi mesataren më të ulët për aftësitë e të menduarit kritik, ndryshe nga nxënësit që kanë sukses të shkëlqyeshëm dhe mesatare më të lartë për aftësitë e të menduarit kritik.

Tabela 9. Rezultatet e ANOVËS brenda dhe ndërmjet grupeve

ANOVA					
Aftësitë e të menduarit kritik					
	\sum^2	df	M^2	F	Sig.
Ndërmjet grupeve	1540.436	3	513.479	4.279	.006
Brenda grupeve	24842.332	207	120.011		
Shuma	26382.768	210			

Sipas të dhënave në tabelën e mësipërme nga rezultatet e ANOVËS mes grupeve që sipas testit të Levenit në tabelën e mësipërme grupet kishin homogjenitet në mes veti në mes grupeve të analizuar ka dallime të rëndësishme statistikore domethënë ekzistojnë dallime mes nivelit të aftësive të të menduarit kritik dhe suksesit.

IV. Diskutime dhe rekomandime

Qëllimi i këtij studimi është të identifikojë nëse nxënësit kanë të zhvilluar aftësitë e të menduarit kritik, cilin stil e kanë më prezent gjatë të mësuarit dhe çfarë stile përdorin mësimdhënësit gjatë mësimit apo realizimit të procesit edukativ - arsimor.

4.1 Stilet e të mësuarit

Rezultatet treguan se të gjitha stilet nga ana e nxënësve përdoren pasi kemi një dallim shumë të vogël në të tre stilet e të mësuarit dhe të nxënësve, por stili pak më mbizotërues nga stilet tjera është stili vizual, më pas ai auditor dhe kinestetik apo i prekjes (taktil).

Kërkimet e kryera në kampione të ndryshme zbuluan rezultate të ndryshme. Pasi popullata e këtij studimi kanë qenë nxënësit e shkollave të mesme dhe mësimdhënësit të po këtyre shkolla.

Në një studim gjithsej 472 pyetësorë u shpërndanë studentëve dhe 372 u plotësuan dhe u kthyen, duke dhënë një normë përgjigjeje prej 78.8%. Hulumtimi tregon shpërndarjen e frekuencës (%) të stileve të të mësuarit një-modal në lidhje me drejtimet arsimore. Ndërsa stili i të mësuarit kinestetik ishte më i përhapuri për të gjithë drejtimet arsimorë, me përjashtim të drejtimit kinez, përqindja e studentëve që preferuan atë kinestetik ndryshonte në mënyrë të konsiderueshme midis drejtimeve të ndryshme. Preferohej nga 17.0 për qind e studentëve anglezë, 18.3 për qind e studentëve që mësojnë tajlandisht, 21.4 për qind e studentëve që drejtojnë studime angleze dhe 27.5 për qind e studentëve që drejtojnë gjuhën japoneze. Për studentët e diplomuar kinezë, modaliteti i dëgjimit (11.8%) ishte i duhuri preferenca më e përhapur e të mësuarit unimodal, e ndjekur nga mënyrat e leximit-shkrimit (9,1%) dhe vizuale (7,3%). Ky rezultat tregon qartë se nxënësit preferojnë pjesëmarrje aktive në procesin e marrjes së njohurive. Prandaj, strategjitë aktive të të mësuarit që akomodojnë stile të shumta të të mësuarit, të tilla si lojë me role, debate, lojëra dhe diskutime në klasë duhet të promovohen në klasë. Në veçanti, mësuesit mund t'i përdorin këto aktivitete aktive të të nxënësve madje në klasa të mëdha (Cortright et al., 2005; Lujan & DiCarlo, 2006).

Gjetjet treguan se drejtimet drejtuese ishin më shumë nxënës kinestetikë, ndërsa drejtimet e marketingut ishin më shumë nxënës vizualë (Nikki, Stephen, & Marie, 2015). Përveç kësaj, rezultatet e studimeve të tjera (p.sh. Hativa, N., Birenbaum, M., 2000; Jones, Reichard, & Mokhtari, 2003; Moayyeri, 2015; Ultanir, Ultanir, & Orekeci Temel, 2012) zbuluan ndryshime të konsiderueshme në preferencat e stilit të të mësuarit midis studentëve të fushave të ndryshme të studimit.

Në rezultatet e studimit tonë te gjinia femërore kemi stilin vizual të të mësuarit me një mesatare pak më të lartë se sa te gjinia mashkullore ndryshe nga rezultatet e hulumtimit që të dhënat e rezultateve kanë dalë me preferencë më të lartë për stilin vizual te gjinia mashkullore, ndërsa femrat më shumë preferojnë stilin e leximit – shkrimit dhe mënyrat e dëgjimit.

Stilet e preferuara të të nxënësve nga, studentët' mund të ndikohen nga kultura për shkak socializimit e kulturave të ndryshme. Rezultatet nga kërkimet e mëparshme (p.sh. Becher & Trowler, 2001; Kolb, 1981, 1993) tregojnë se stilet e të nxënësve të studentëve ndryshuan sipas lëndës së studiuar.

4.2 Aftësitë e të menduarit kritik

Hulumtimi ynë është realizuar te të gjithë nxënësit e shkollave të mesme pa dallime në sukses apo duke u bazuar në talentet e nxënësve dhe pa mos marrë parasysh se me çfarë programesh ato mësojnë, por nëse ndalemi te gjinia e nxënësve shohim një dallim për aftësitë e të menduarit kritik te gjinia femërore dhe ajo mashkullore. Te gjinia femërore kemi aftësitë e të menduarit kritik më të lartë në krahasim me nxënësit e gjinisë mashkullore që kanë një mesatare më të ulët.

Te rezultatet e studimit edhe pse nuk kemi përcaktuar mostrën se me çfarë aftësi do të marrin pjesë në studim, por kemi bërë krahasimin e suksesit të nxënësve me aftësitë e të menduarit kritik ku kemi mesataren te nxënësit me sukses të shkëlqyeshëm $M= 76.99$ dhe nxënësit me mesatare të dobët me mesatare $M= 65.58$. Dhe nga kjo mund të konstatojmë se nxënësit që kanë sukses më të lartë kanë edhe aftësi më të zhvilluara të të menduarit kritik.

4.3 Stilet e mësimdhënies

Rezultatet për stilin e pestë që është mësuesi ligjërues para një auditori më të madh kemi këto vlera të studimit 6.96 te gjinia femërore e stileve të mësimdhënësve dhe te gjinia mashkullore kemi vlerat 7.52 te gjinia mashkullore.

Dhe rezultatet te stili i gjashtë mësuesi i vetëm që nuk ndjek progresin e nxënësve kemi këto vlera te gjinia femërore 11.96, dhe te gjinia mashkullore 11.07 i stilit të mësimdhënies.

Sipas gjinisë, i vetmi nga gjashtë faktorët që treguan një ndryshim të rëndësishëm ishte në faktorin e madh të mësuesit të konferencës mësuesi ligjërues para një auditori më të madh, e cila ishte më e forta te meshkujt, me një vlerë $p 0,025$ (Mohanna. K, Chambers. R, Wall. D, 2008)

V. Conclusion

Working on learning styles, critical thinking and teaching styles in high schools in the city of Tetovo, in this empirical research are described descriptive data for the three variables mentioned above from the selected sample, the main purpose of the paper is to identify which learning style is most dominant in students, how well they have developed critical thinking skills, and what style teachers use in teaching. 211 students and 56 teachers participated in the research. In the research there are 77% of female and 23% of male students participating, while

teachers have participated 48% of female and 52% of male teachers. Through the survey the students have completed the online questionnaire as well as the teachers. With reliability of tests for learning styles ($\alpha = 0.32$), with critical thinking with reliability ($\alpha = 0.86$) and with teaching styles ($\alpha = 0.72$).

The results show that the visual style of learning is more dominant on students use and is at a slightly higher percentage than other styles. Critical thinking in women is higher than in the opposite sex and students who are more successful also have higher critical thinking skills.

Recensentë:

Prof. Dr. Rabije Murati
Doc. Dr. Valdeta Zenuni -Idrizi

Bibliografia

Beatty, B. (1998). From laws of learning to a science of values: Efficacy and morality in Thorndike's educational psychology. *American Psychologist*, 53, 1145-1152.

Becher, T. & Trowler, P. (2001). *Academic Tribes and Territories*. Buckingham: Society for Research in Higher Education/Open University Press.

Cassidy, S. (2004) Learning styles: An overview of theories, models, and measures. *Educational Psychology*, 24 (4), 419- 441.

Glassman, M. (2001). Dewey and Vygotsky: Society, experience, and inquiry in educational practice. *Educational Researcher*, 30(4), 3-14.

Hançerlioğlu, O. (1996). *Felsefe Sözlüğü*. İstanbul: Remzi Kitabevi:31.

Hativa, N., & Birenbaum, M. (2000). Who prefers what? disciplinary differences in students' preferred approaches to teaching and learning styles. Retrieved on December 15, 2017 from: <http://link.springer.com/article/10.1023/A%3A1007095205308>.

Hayes, K., & Devitt, A. (2008). Classroom discussions with student-led feedback: a useful activity to enhance development of critical thinking skills. *Journal of Food Science Education*, 7(4), 65-68. doi: 10.1111/j.1541- 4329.2008.00054.x

Innis, G. (2015). Critical thinking: Another essential life skill. Help children learn to think critically to achieve success in school and in life. Retrieved from <https://tinyurl.com/ya337bt4>

James, W. B., and Gardner, D. L. (1995) Learning Styles: Implications for Distance Learning. *New Directions for Adult and Continuing Education* no. 67, 19-32.

Jones, C., Reichard, C., & Mokhtari, K. (2003). Are students' learning styles discipline specific? *Community College Journal of Research and Practice*, 27(5), 363-375.

Kolb, D. A. (1981). Learning styles and disciplinary differences. *The Modern American College*, 1, 232-255

Massa, L.J., & Mayer, R.E. (2006) Testing the ATI hypothesis: Should multimedia instruction accommodate verbalizer-visualizer cognitive style? *Learning and Individual Differences*, 16, 321-336.

McGregor Debra (2007). *Developing Thinking, Developing Learning*. Open University Press, 9

McGregor Debra (2007). *Developing Thinking, Developing Learning*. Open University Press, 9

Moayyeri, H. (2015). The impact of undergraduate students' learning preferences (VARK Model) on their language achievement. *Journal of Language Teaching and Research*, 6(1), 132-139.

Mohanna, K, Chambers, R, Wall, D, (2008). *Your Teaching Style A practical guide to understanding, developing and improving*. International Standard Book Number-13: 978-1-138-03033-6 (eBook - PDF). Parkway: ProQuest)

Musai, B. (2003). *Metodologji e Mësimdhënies*. Tiranë: CDE.

Naimie, Z., Siraj, S., Piaw, C. Y., Shagholi, R., Abuzaid, R. A. (2010) Do you think your match is made in heaven? Teaching styles/ learning styles match and mismatch revisited. *Procedia Social Behavioral Sciences*, 2, 349-353.

Nikki, S., Stephen, F. & Marie, K. (2015). How college Business students learn with emphasis on differences between majors. *Journal of College Teaching & Learning*, 12(4), 223-230.

Peacock, M. (2001) Match or mismatch? Learning styles and teaching styles in EFL. *International Journal of Applied Linguistics*, 11(1), 1-20.

Reid, J.M. (1995) *Learning Styles in the ESL/EFL Classroom*. Boston: Heinle & Heinle Publishers

Reid, J.M. (1995) *Learning Styles in the ESL/EFL Classroom*. Boston: Heinle & Heinle Publishers

Santrock, J. W. (2006). *Educational Psychology* (2nd ed.). New Delhi: Tata McGraw-Hill Publishing Company Limited.

Sternberg, R. J. (1987). Teaching critical thinking: Eight easy ways to fail before you begin. *The Phi Delta Kappan*, 68(6), 456-459.

Tuan.L.T. (2011) Matching and Stretching Learners' Learning Styles. *Journal of Language Teaching and Research*, 2(2), 285-294

Ultanir, E., Ultanir, Y. G., & Orekeci Temel G. (2012). The examination of university students' learning styles by Means of Felder-Silverman Index. *Education and Science*, 37(163), 29-42.